



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

1	Data	05.12.2025	Vendi	Kaçanik
Nj. org.	Numri	Shënime		
01	340/01-30066	1.		

KONTRATA PËR FURNIZIME

Komuna e Kaçanikut (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), i përfaqësuar nga **Izahir Kuka –u.d i Menaxherit të Prokurimit**; në njërën anë dhe

"**RIMI ALTEX**". nga **Ferizaj** (në vazhdim "Operatori Ekonomik"), i përfaqësuar nga i autorizuar **Durim Goga me Nr. Personal 1174260849** në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi me uniforma për nevojat e punëtorëve të QKMF- së

me numër Identifikues : **652-25-10157-1-3-6**

KA652/24/071/136

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të **Furnizimi me uniforma për nevojat e punëtorëve të QKMF- së**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me **08.12.2023 deri 23.12.2023**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **15 ditë** nga data e nënshkrimit të kontratës

1.4 Vendi **QKMF -Kaçanik**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë **DDP¹** (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë **LPP-04/L-042**. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **3,057.00 €**,
me fjalë (**Tremijëepesëdhjetëeshtatëeuro**).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro në llogarin Bankare).

Autoriteti Kontraktues do të paguaj OE dhe atë pas pranimit të shërbimit nga ana e komisionit për pranim

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 00 muaj, pas pranimit të **Furnizimit**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin **[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët]** brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së **[furnizimeve] [punëve] [shërbimeve]** të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e

caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën komunale në Kaçanik në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip] [Serbisht] [Anglisht] 2 në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Durim Goga	Emri:	Izahir Kuka
Pozita:	I autorizuar	Pozita:	U.d. Menagjer i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	05.12.2025	Data:	05.12.2025
Vula:		Vula:	

Numri i Prokurimit: 652-25-10157-1-3-6 – Titulli *Furnizim me uniforma për nevojat e puntorëve të QKMF-së*

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Nr. i Artikullit	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi njesi DDP ⁵ - €	Çmimi total €	Koha e dërgesës
1.	Uniforme 4 pjesëshe për personel të urgjencës me ngjyra teget	Pal	18	60.00	1.080.00	20 Ditë
2.	Këpucë të thella për teren	Pal	13	25.00	325.00	20 Ditë
3.	Mantela për Higjieniste (me gjyra hiri e mbyllët)Femra	Cop	18	14.00	252.00	20 Ditë
	.Uniforma për femra me magë të shkurt	pal	18	25.00	450.00	20 Ditë
etj	Mbathje për femra (kllampe) me lëkurë 100% të bardha ortopedike :	pal	38	25.00	950.00	20 Ditë
Totali i Përgjithshëm:					3.057.00	

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	RIMI-ALTEX Sh.p.k
ADRESA E PLOTE	"Dëshmoret e Kombit" pn - Ferizaj Kosove
PËRFAQESUAR NGA:	
EMRI	Trim Goqa
POZITA	Drejtor
NENSHKRIMI	
DATA	12.11.2025
VULA	

⁵ Detyrimi i Dorëzimit është Paguar - Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Kryetari i Komunës
01 Nr. 370/01-30066
Kaçanik, 05.12.2025

Në bazë Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 të
Rregullores 001/2022 Për Prokurimi Publik nenit 70 , Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E MENAXHERIT TË PROJEKTIT

I. Me këtë vendim emërohet Menaxher i projektit **Arben Koxha**, në Projektin: **Furnizimi me uniforma për nevojat e punëtorëve të QKMF—së**, në bazë të Kontratës **01NR.370/01-30066** të datës **05.12.2025**

II. Menaxheri i projektit do të jetë përgjegjës për menaxhimin e projektit të lartpërmendur, do të raportoj me shkrim ZKA, Zyren e Prokurimit, **DSHMS** mbi realizimin e punëve në teren.

III. Sipas këtij vendimi Menaxherët e projektit do të jenë të angazhuar në procesin e implementimit të projektit, bazuar në përgjegjësit sipas LPP-se dhe Rregullores së Prokurimit Publik.

IV. Me këtë vendim të njoftohet: Menaxheri, Zyra e prokurimit , OE dhe **DSHMS**.



Kryetari i komunës
Z/ Sabedin Vishi